

Bilanci i Energjisë Elektrike

Metadate Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure

(ESMS)

INSTAT

Metadate Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse	4
5. Periudha e referencës	4
6. Mandati institucional.....	4
7. Konfidencialiteti	5
8. Politika e botimit.....	6
9. Shpeshësia e shpërndarjes.....	6
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	6
11. Manaxhimi i cilësisë	7
12. Rëndësia.....	7
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	8
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	8
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria.....	9
16. Kostoja dhe ngarkesa	9
17. Rishikimi i të dhënave.....	9
18. Përpunimi statistikor	9
19. Komente.....	10
Aneks	10

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave Strukturore, Drejtoria e Statistikave Ekonomike
1.3. Personi i kontaktit	Ermira Palushi
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Përgjegjës, Sektori i Statistikave Strukturore
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Shqipëri
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	epalushi@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+ 355 (4)2 2233358/249
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 2228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	02.03.2023
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	02.03.2023
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	02.03.2023
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Statistikat mbi energjinë elektrike prodhohen me periodicitet tremujorë dhe vjetorë (të detajuara sipas muajve), bazuar në burimet administrative mbi sasinë e energjisë elektrike në vend.</p> <p>Në bazë të këtyre statistikave hartohet Bilanci i energjisë elektrike. Të dhënat i referohen prodhimit, shkëmbimit, konsumit dhe humbjeve të energjisë elektrike.</p>
3.2. Sistemi i klasifikimit	Nuk aplikohet për aktivitetin statistikor të Bilancit të energjisë elektrike.
3.3. Mbulimi i sektorit	<p>Bilanci i Energjisë Elektrike jep informacion statistikor mbi prodhimin neto vendas të energjisë elektrike, importin dhe eksportin bruto të energjisë elektrike, humbjet në rrjet si edhe konsumin final në vendin tonë.</p> <p>Statistikat për energjinë elektrike publikohen për periudha tremujore nga të</p>

	<p>dhënat mujore të grumbulluara prej burimeve administrative si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • KESH sh.a, shoqëri e pavarur shtetërore që prodhon, transformon dhe kryen shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike; • OSSH sh.a, shoqëri e pavarur shtetërore që kryen shpërndarjen e energjisë elektrike, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike; • OST sh.a, shoqëri e pavarur shtetërore që operon në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike nga pikëpamja fizike dhe e shpërndarjes. OST sh.a garanton kapacitetet e nevojshme transmetuese për: <ul style="list-style-type: none"> – furnizimin e pa ndërprerë me energji elektrike të nënstacioneve të sistemit të shpërndarjes dhe konsumatorëve të energjisë elektrike të lidhur direkt në rrjetin e transmetimit; – transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vendit; – tranzitet dhe shkëmbimet e nevojshme me vendet e rajonit.
<p>3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime</p>	<p>Përkufizimet e variablave bazë</p> <p>Energji në dispozicion referohet sasisë së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhimi vendas i energjisë elektrike plus sasisë së importuar (përfshirë këmbimet) minus sasisë së eksportuar (përfshirë këmbimet).</p> <p>Prodhimi neto vendas llogaritet si shumë e sasisë së energjisë elektrike të prodhuar nga të gjithë prodhuesit në vend si prodhimi i hidrocentraleve, termocentraleve dhe prodhuesit e tjerë.</p> <p>Energji termo i referohet energjisë elektrike të prodhuar nga termocentralet.</p> <p>Energji hidro i referohet sasisë së energjisë elektrike të gjeneruar nga uji në hidrocentrale.</p> <p>Konsumi dhe humbjet vetjake i referohet energjisë elektrike të përdorur nga veprimtaritë ndihmëse të stacionit të energjisë të lidhura direkt me prodhimin si psh. ftohje e ujit, shërbimet e stacionit të energjisë, ngrohje, ndriçim, etj.</p> <p>Prodhues të pavarur privatë dhe koncesionarë u referohen prodhuesve private të energjisë elektrike të cilët në rastin e Shqipërisë përbëhen nga impiante ish-publike të privatizuara ose impiante të ndërtuara nga subjektet private vendëse apo të huaja përmes kontratave koncesionare me Republikën e Shqipërisë. Këta prodhues lidhen direkt në sistemin e transmetimit dhe liçensohen nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) dhe mund të shesin kapacitete ose energji OST-së dhe OSHEE-së, për të mbuluar humbjet në sistemin e transmetimit dhe shpërndarjes, si edhe tek klientë të tjerë.</p> <p>Prodhues të tjerë i referohet prodhimin të energjisë elektrike nga burime të tjera të energjisë, duke përfshirë energjinë hidro dhe termo.</p> <p>Shkëmbimi i energjisë elektrike i referohet diferencës midis eksportit dhe importit të energjisë elektrike. Kjo përfshin edhe tranzitet dhe shkëmbimet</p>

	<p>(dhënie - marrje energjie) e nevojshme të energjisë elektrike me vendet e rajonit.</p> <p>Konsumi i energjisë elektrike i referohet përdorimit nga konsumatorë familjarë dhe jo familjarë dhe sasisë së humbjeve në rrjet të energjisë elektrike.</p> <p>Humbjet në rrjet përbëjnë humbjet në transmetim duke përfshirë edhe konsumin vetjak në transmetim si edhe humbjet në shpërndarje. Humbjet teknike në shpërndarje janë të vlerësuara nga OSHEE sh.a. Humbjet jo teknike i referohen diferencës së humbjeve gjithsej në shpërndarje me humbjet teknike në shpërndarje.</p> <p>Përdorimi nga konsumatorët është i barabartë me shumën e energjisë elektrike 4 të konsumuar nga konsumatorë familjarë dhe jo familjarë:</p> <p>Familjarët i referohet sasisë së konsumit të energjisë elektrike në familje.</p> <p>Jo familjarët i referohet sasisë së konsumit të energjisë elektrike nga sektorët e industrisë, transportit, agrikulturës, shërbimeve publike, etj. duke përjashtuar konsumin nga familjarët.</p>
3.5. Njësia statistikore	Operatorët të cilët kryejnë prodhimin, transmetimin ose shpërndarjen e energjisë elektrike.
3.6. Popullata statistikore	Të gjithë prodhuesit, transmetuesit dhe shpërndarësit e energjisë elektrike në vend.
3.7. Zona e referencës	Bilanci i energjisë elektrike përfshin të gjithë territorin e Shqipërisë.
3.8. Mbulimi në kohë	Të dhënat e mbledhura për Bilancin e energjisë elektrike datojnë që nga viti 1993.
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.
4. Njësia matëse	MWh (mega vat për orë)
5. Periudha e referencës	Ky raport i përket vitit referencë 2022.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>Baza ligjore mbi të cilën u mbështetet bilanci i energjisë elektrike përbëhet nga:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ligji Nr. 17/2018 "Për statistikën zyrtare" 2. Programi i Statistikave Zyrtare për periudhën 2022-2026 3. Vendimet e Këshillit të Statistikave. Duke qenë se, sipas ligjit të statistikave zyrtare, roli i këtij organi është të mbikëqyrë, mbështesë dhe të marrë vendime në ndihmë të INSTAT-it dhe agjencive të tjera statistikore për të siguruar hartimin dhe zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare, aktet e miratuara nga ky organ janë të rëndësishme për ecurinë e zbatimit të aktiviteteve statistikore si dhe monitorimin e performancës së institucioneve përbërëse të sistemit kombëtar statistikor.

	4. Memorandumet e bashkëpunimit të hartuara me institucionet e tjera.
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	<p>Statistikat e energjisë elektrike transmetohen në EUROSTAT si pjesë e bilancit të përgjithshëm të energjisë së përpiluar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN).</p> <p>Aktualisht INSTAT i dërgon disa nga treguesit kryesorë Komisionit Evropian si edhe plotëson një sërë pyetësorësh të organizmave ndërkombëtare në lidhje me statistikën e energjisë elektrike vjetore në vend.</p>
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	<p>Të dhënat e mbledhura nga operatorët e energjisë elektrike konsiderohen si rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligjin Nr. 17/2018 "Për statistikën zyrtare", si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për "Statistikën zyrtare" përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.</p>
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	<p>INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësisë statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësisë statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se:</p> <p>a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregulloren, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose</p> <p>b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave;</p> <p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë akses tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktuara shkallën e detajeve që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomanduara se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.</p>

8. Politika e botimit	
8.1. Kalendarin e publikimeve	Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendarin. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Aksesin në kalendarin e publikimeve	Kalendarin e Publikimeve është në dispozicion në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Aksesin e përdoruesve	Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias, INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e Bilancit të Energjisë janë si më poshtë: 1. Website – online release 2. Kërkesat e shkruara (me postë ose email); 3. Publikimet 4. Kërkesë të dhënash , seksion për përdorues të jashtëm.
9. Shpeshësia e shpërndarjes	
	Bilanci i energjisë elektrike publikohet mbi baza tremujore dhe vjetore.
10. Aksesin në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	Njoftimi për shtyp përmban informacion në lidhje me prodhimin neto vendas, energji termo, energji hidro, konsumi dhe humbjet vetjake, prodhimin e prodhuesve të pavarur privatë dhe koncesionarë, prodhimin e prodhuesve të tjerë, shkëmbimin e energjisë elektrike, konsumin e energjisë elektrike, humbjet në rrjet, përdorimin nga konsumatorët, përdorimi nga konsumatorët familjarë dhe jo familjarë. Formati i njoftimit për shtyp nuk ka ndryshuar; ajo është përcaktuar nga sektori i publikimit, i cili vendos edhe datën e publikimit. Njoftimi për shtyp publikohet online në faqen e internetit të INSTAT: Energjia
10.2. Publikime	Rezultatet e Bilancit të energjisë elektrike gjenden të botuara në faqen zyrtare të INSTAT si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> • Shifrat • Vjetari Statistikor
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë: Shqip dhe Anglisht. Që nga viti 2011, përmes sistemit Pc-Axis, për përdoruesit e jashtëm në faqen e internetit ofrohet seria kohore e bilancit nga viti 2000 si viti referencë. Gjithashtu në këtë faqe interneti ka një shpjegim të thjeshtë metodologjik.

	Bazën e të dhënave e aksesoni më poshtë: Databaza
10.4. Aksesimi në të dhënat mikro	Aksesimi në të dhëna mikro nuk aplikohet për të dhënat e Bilancit të energjisë elektrike.
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një seksioni të dedikuar për kontakt në linku: Kërkesë të dhënash
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me Metodogjinë mbi hartimin e Bilancit të energjisë elektrike.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave Strukturore dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat e hartimit të bilancit të energjisë elektrike për qëllime të brendshme.
11. Manaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në Ligjin Nr. 17/2018 "Për statistikën zyrtare", INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranura ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	<p>Sigurimi i cilësinë bëhet nëpërmjet kontrolleve të rregullta për operatorët që veprojnë në fushën e energjisë elektrike. Verifikimet përfshijnë konsistencën e vlerave të energjisë elektrike lidhur me prodhimin, konsumin, shkëmbimin e energjisë elektrike, humbjet në rrjet, përdorimin nga konsumatorët etj.</p> <p>Të dhënat e bilancit të energjisë elektrike krahasohen me të dhënat e viteve të kaluara për të parë trendin e treguesve të këtij bilanci. Nëse vihen re diferenca statistikore mbi 5%, atëherë verifikohen edhe njëherë të dhënat nga evidencat me operatorët e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.</p>
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Përdoruesit e bilancit të energjisë elektrike janë përdorues të jashtëm. Me përdorues të jashtëm nënkuptojmë:</p> <p>Institucione të administratës publike,</p> <ul style="list-style-type: none"> • Universitetet • Organizatat jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare

	<ul style="list-style-type: none"> • Bizneset • Kërkues, student edhe të tjerë grupe të ngjashme. <p>Bilanci i energjisë elektrike i dërgohet në baza tremujore dhe vjetore një grupi të caktuar përdoruesish me e-mail.</p>						
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Page Views (Klikime) në lidhje me Bilancin e Energjisë Elektrike për vitin 2022 janë rreth 8,329 klikime.</p> <p>Gjatë 2022 INSTAT ka kryer vrojtimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve. Rezultatet e vrojtimit për 2022 tregojnë se cilësia e përgjithshme e temës "Energjia" është vlerësuar me 3.48 (69.6%) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).</p> <p>INSTAT organizon cdo vit Anketën e Kënaqësisë se Përdoruesve.</p>						
12.3. Plotshmëria	<p>Plotshmëria e të dhënave për statistikën e “Bilancin e Energjisë Elektrike” për vitin 2022 gjykohet duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar në INSTAT nga ato të parashikuara në Programin e Statistikave zyrtare (2022-2026). Shkalla e plotshmërisë së të dhënave të vitit 2022, për Bilancin e Energjisë Elektrike është 100%.</p>						
13. Saktësia dhe besueshmëria							
13.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Në përgjithësi të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në ecurinë e të dhënave si dhe me operatorët e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.</p>						
13.2. Gabim i kampionimit	<p>Nuk aplikohet.</p>						
13.3. Gabim jo i kampionimit	<p>Sa i përket gabimeve të jo kampionimit, fjala është kryesisht për disa gabime në raportimin e të dhënave nga burimet administrative. Rishikimi i të dhënave ndodh vetëm në rast se institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT për efekt përditësimi. Nëse institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT, atëherë në publikimin më të afërt do të pasqyrohen këto ndryshime dhe do të jepet një informacion i shkurtër sqarues për përdoruesit.</p> <p>Mos përgjigje të njëjësive statistikore nuk kemi sepse të dhënat janë siguruar nga burime administrative të cilat kanë detyrim ligjor ti përgjigjen kërkesave të INSTAT. Mos-përgjigje në nivel variabli gjithashtu nuk ka sepse çdo operator ka detyrim ligjor të plotësojë çdo tregues të kërkuar nga INSTAT.</p>						
14. Afatet kohore dhe përpikmëria							
14.1. Afatet kohore	<p>Rezultatet e “Bilancit të Energjisë Elektrike” janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 61 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T + 61 ditë). Periudha referuese e rezultateve të Bilancit të Energjisë Elektrike 2022 është 31 Dhjetori 2022</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2022</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>3/2/2023</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>61</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2022	Data e publikimit	3/2/2023	Afatet kohore	61
Periudha referuese	12/31/2022						
Data e publikimit	3/2/2023						
Afatet kohore	61						

14.2. Përpikmëria	<p>Të dhënat e Bilancit të Energjisë Elektrike, publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i Bilancit të Energjisë Elektrike ka qenë i përpiktë në kohë në 100 % të publikimeve të kryera gjatë viteve.</p> <table border="1" data-bbox="576 241 1107 383"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2022</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>3/2/2023</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>3/2/2023</td> </tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td> <td>0</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2022	Data e shpallur	3/2/2023	Data e publikimit	3/2/2023	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2022								
Data e shpallur	3/2/2023								
Data e publikimit	3/2/2023								
Vonesa në kohë	0								
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria									
15.1. Krahasueshmëria gjeografike	Informacioni i të dhënave të Bilancit të energjisë elektrike është i krahasueshëm gjeografikisht sepse ato sigurohen nga burime administrative.								
15.2. Krahasueshmëria kohore	Statistikat e Bilancit të energjisë elektrike datojnë që nga viti 1993. Të dhënat nga viti 2000 janë më të krahasueshme në seri kohore, duke na garantuar një krahasueshmeri prej 23 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=23).								
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Nuk aplikohet.								
15.4. Koherenca e brendshme	Konsistenca e brendshme e të dhënave kontrollohen para se të finalizohen. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca në serinë e tyre.								
16. Kostoja dhe ngarkesa	Për të hartuar dhe prodhuar bilancin e energjisë elektrike, punon vetëm një punonjës pranë zyrave qendrore. Kostot e prodhimit të bilancit të energjisë elektrike janë minimale duke qenë se për mbledhjen e të dhënave përdoret shkresa zyrtare (nëpërmjet postës) dhe me anë të email-it.								
17. Rishikimi i të dhënave									
17.1. Politika e rishikimit	<p>Politikat e rishikimit të bilancit të energjisë elektrike bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë referohuni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Politika e revizionimit • Politika e trajtimit të gabimeve 								
17.2. Praktika e rishikimit	Të dhënat e energjisë elektrike rishikohen në rastet kur ka njoftime për ndryshime nga raportimet e operatorëve. Të gjitha rishikimet janë bërë transparente për përdoruesit dhe janë pjesë e çdo botimi.								
18. Përpunimi statistikor									
18.1. Burimi i të dhënave	<p>Si burim i vetëm i mbledhjes së të dhënave janë të dhënat administrative të siguruara nga tre operatorët që operojnë në fushën e energjisë elektrike:</p> <ul style="list-style-type: none"> • KESH sh.a që prodhon, transformon dhe që kryen shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike; • OSSH sh.a që kryen shpërndarjen e energjisë elektrike, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike; 								

	<ul style="list-style-type: none"> • OST sh.a që operon në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike nga pikëpamja fizike dhe e shpërndarjes.
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat grumbullohen në baza tremujore dhe vjetore, me detajime mujore të grumbulluara prej burimeve administrative.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Të dhënat e bilancit të energjisë elektrike kërkohen me anë të shkresës zyrtare dhe sigurohen nëpërmjet adresave postare ose elektronike.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Vlefshmëria e të dhënave bëhet duke krahasuar të dhënat e vlerave aktuale apo me ato të një viti paraardhës.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Përpilimi i të dhënave i referohet krijimit të një bilanci energjie i cili barazon sasinë e vënë në dispozicion për konsum me sasinë e konsumuar në vend. Në rastin e diferencave statistikore në këto sasi gjykohet në cilësinë dhe saktësinë e të dhënave dhe ju ridërgohet operatorëve për konfirmim të shifrave dhe arsyetim të situatës.
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet. Asnjë përshtatje sezonale nuk i bëhet të dhënave të grumbulluara.
19. Komete	
Aneks	